

VENDIM
Nr. 244, datë 20.4.2022

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “NDËRTIM KOPSHTI DHE ÇERDHE E INTEGRUAR NR. 42”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtim kopshti dhe çerdhe e integruar nr. 42”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 66 620 761.20 (gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e njëzet mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një pikë njëzet) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 66 620 761.20 (gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e njëzet mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një pikë njëzet) lekësh përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

5. Shpenzimet procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Bashkia Tiranë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi paraqesin dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Tiranë.

8. Bashkia Tiranë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tiranë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe bën regjistrimin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të Bashkisë Tiranë.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimi i kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë për pasuritë e shpronësuar.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Jug, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyj në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME QË SHPRONËSOHEN PËR
INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI “NDËRTIM KOPSHITI DHE ÇERDHE E INTEGRUAR NR. 42”

Nr.	Pronari			Të dhëna hipotekore									Vlerësimet për shpronësim							Shënime (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë)
													Truall			Ndërtesë			Vlera totale (lekë)	
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
1	Jorgo Petraq	Gaqo Gaqo	Papadhopuli Papadhopulli	Tiranë	8270	2/899	Truall	657.5	657.5	-	93	107	657.5	66969	44,032,117.50	-	-	-	44,032,117.50	
2	David Mark	Bashkim -	Haxhi Shantoja	Tiranë	8270	2/427	Truall	337.3	337.3	-	24	157	337.3	66969	22,588,643.70	-	-	-	22,588,643.70	
	Total												994.8			0			66,620,761.20	

Për tokën truall, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016.